



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. 6590 Prot.

Tiranë, më 12.9.2014

**LËNDA:** Sqarim mbi planifikimin dhe zbatimin e gjuhës së huaj

**DREJTUAR:** DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE

**ZYRËS ARSIMORE**

Në zbatim të Udhëzimit Nr 23, datë 08.08.2014 "Për vitin shkollor 2014-2015", lidhur me zbatimin e planit mësimor për arsimin bazë, si rezultat i futjes së edukimit fizik dhe problematikës së ngritur nga DAR/ZA-të për zhvillimin e gjuhës së huaj, ju sqarojmë si vijon:

1. Shkollat nuk mund të planifikojnë gjuhë të huaj të dytë për klasat III-IV-V të arsimit fillor. Në këto klasa zhvillohet vetëm një gjuhë e huaj, ajo e detyruar. Për këtë është kërkuar planifikim gjuhësor që në klasën e tretë, me synim ruajtjen e shumëgjuhësisë në këtë cikël. Nga ky planifikim vjen dhe vijimësia e gjuhës së huaj në ciklet pasardhëse, çka nënkupton fillimin në klasën III të arsimit fillor dhe përfundimin në klasën XII të arsimit të mesëm të lartë.

DAR/ZA-të të planifikojnë sipas angazhimeve dypalëshe, në zbatim të Udhëzimit Nr. 23, datë 08.08.2014, Kreu II, pika 5, hapjen e klasave të gjuhës italiane për 10% të nxënësve që zhvillojnë gjuhë të huaja, 30% të nxënësve që zhvillojnë gjuhën frënge dhe 60% për të nxënësve që zhvillojnë gjuhën angleze në klasën III të arsimit fillor, duke filluar nga viti shkollor 2014-2015. Planifikimi i shkollave të bëhet nga DAR/ZA-ja në varësi të kuadrit mësimdhënës dhe strukturës së shkollës duke qenë sa më fleksibël në realizimin e këtij planifikimi.

Në klasat IV dhe V nuk lejohet të zhvillohet gjuha e huaj si veprimtari jashtëkurrikulare dhe lëndë me zgjedhje.

2. Gjuha e huaj e dytë, e zhvilluar në klasat VI-IX, nuk është gjuhë e detyruar, ajo planifikohej dhe zbatohet në veprimtaritë jashtëkurrikulare dhe lëndët me zgjedhje, sipas kërkesave dhe situatës në çdo DAR/ZA.

Në zbatim të Udhëzimit 23, në klasën VI gjuha e huaj mund të planifikohet në veprimtaritë jashtëkurrikulare dhe në lëndët me zgjedhje, duke përdorur orën e planifikuar dhe duke shtuar një orë përtej orarit mësimor. Në klasat VII-IX aktuale, në kushtet kur nuk ka orë të planifikuara për vijimësinë e gjuhës së huaj të nisur në vitin e kaluar, nëse shkolla e shikon të domosdoshme dhe interesi është i madh si nga prindërit nxënësit dhe mësuesit, për të siguruar vijimësinë, të gjendet konsensusi që orët e mësimit të gjuhës së huaj të zhvillohen me orar shtesë mbi planin mësimor. Shpërndarja e orëve të bëhet nga drejtori i shkollës, si pjesë e organizimit të orarit të mësimëve. Mësuesit që do të angazhohen për këtë, të jenë brenda normës së tyre mësimore.

3. Në gjimnaz, futja e lëndës së edukimit fizik nuk duhet të krijojë problematikë, sepse gjuha e huaj e dytë, që është zgjedhur, në mbështetje të udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës, për nxënësit që e kanë zgjedhur dhe sot janë në klasën XI dhe XII, vijon. Në klasën X është në vartësi të zgjedhjes së nxënësve, kështu që nuk përbën problem.
4. Në zbatimin të marrëveshjeve dhe memorandumëve të seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-gjerman në DAR Tiranë, shqiptaro-francez në DAR Tiranë, Korçë, Elbasan, Shkodër e Durrës, si dhe të seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-italiane në DAR Tiranë, Korçë dhe Shkodër, gjuha e huaj në klasat VI-IX është gjuhë e huaj e parë dhe do të zhvillohet si deri tani.
5. Planet mësimore të gjimnazeve me orientim gjuhësor, seksioneve dygjuhëshe, shkollave artistike, të baletit dhe atyre të arsimit profesional janë po ato që janë zbatuar vitin e kaluar.

DAR/ZA-të dhe shkollat të marrin masat për zbatimin e kësaj shkrese.

PLARENT NDRECA  
  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

